




KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
Prishtinë - Prishtina

KOLEGJI "PJETËR BUDI" - PRISHTINË



RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN PROCEDURAVE PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE

Prishtinë, 2020



Në bazë të nenit 92 të Statutit të Kolegjit "Pjetër Budi", Senati Akademik i Kolegjit "Pjetër Budi", me datën 28.12.2020, miratoi këtë:

RREGULLOREN PËR PËRCAKTIMIN PROCEDURAVE PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Me dispozitat e kësaj Rregulloreje përcaktohen afatet, kriteret dhe kushtet e regjistrimit të studentëve, organizimi i testit pranues, vlerësimi i suksesit në shkollën e mesme, dokumentacioni i nevojshëm për aplikim dhe regjistrim të studentëve në Kolegjin "Pjetër Budi" - Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm "Kolegji "Pjetër Budi").

Neni 2

2.1. Të drejtën për tu regjistruar në Kolegjin "Pjetër Budi", e kanë të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe të cilët e kanë kaluar testin kombëtar të maturës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2.2. Të drejtën për tu regjistruar në Kolegjin "Pjetër Budi", e kanë edhe kandidatët nga shkollat e mesme profesionale, e të cilët e kanë dhënë provimin përfundimtar (kanë marrë diplomë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi).

2.3. Kandidatët të cilët e kanë kryer arsimin e mesëm jashtë Republikës së Kosovës, kanë të drejtë të regjistrohen në Kolegjin "Pjetër Budi", mirëpo janë të obliguar që në ndërkohë ta nostifikojnë diplomën në Ministrinë e Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

II. Afati i paraqitjes së studentëve për regjistrim

Neni 3

Afati për pranimin e studentëve në Universiteti bëhet përmes konkursit publik, i cili publikohet në mjetet e informimit publik të Kosovës dhe në Web faqen elektronike të Kolegjit "Pjetër Budi".

Neni 4

Paraqitja e kandidatëve për regjistrim në Kolegjin "Pjetër Budi", bëhet nga data 16 qershor deri me datën 30 shtator, apo me Vendim të Bordit Drejtues mund të përcaktohet ndonjë afat tjetër plotësues.



III. Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të studentëve

Neni 5

5.1. Kusht kryesor për regjistrimin e studentëve në Kolegjin "Pjetër Budi", është përfundimi i arsimit të mesëm, dhënia e provimit të maturës.

5.2. Përparësi me rastin e regjistrimit në Kolegjin "Pjetër Budi", (pikë shtesë), kanë nxënësit që kanë pasur drejtimet e njëjta në shkollën e mesme, me ato në të cilat aplikojnë në Kolegj.

5.3. Nxënësve me sukses të shkëlqyeshëm, Kolegji "Pjetër Budi", iu ofron zbritje prej 10% të vlerës së përgjithshme të çmimit të regjistrimit.

IV. Testi pranues

Neni 6

6.1. Për fusha të veçanta studimi, Kolegji mund të organizojë provime shtesë – provim pranues për disa lëndë, në procedurën e pranimit të studentëve.

V. Vlerësimi i suksesit në shkollën e mesme

Neni 7

7.1. Vlerësimi i suksesit në shkolla të mesme dhe të testit kombëtar të maturës, shprehet me anë të pikëve dhe në bazë të pikëve bëhet renditja e kandidatëve të pranuar.

7.2 Listën përfundimtare të rangimit të kandidatëve të pranuar, në bazë të pikëve të fituara në arsimin e mesëm, e bënë Komisioni i posaçëm i formuar nga Këshilli Mësimor Shkencor i Kolegjit "Pjetër Budi".

7.3. Komisioni i posaçëm listat preliminare dhe përfundimtare të rangimit i shpall në tabelat e shpalljeve të Kolegjit dhe në Web faqen elektronike të Kolegjit.

7.4. Kandidati i cili nuk është pranuar – regjistruar në Kolegj, ka të drejtë kundërshtimi në afat prej 3 ditësh pas publikimit të rezultateve.

7.5. Pas ankesës Vendimi është përfundimtar dhe më pas Komisioni lëshon Vendim për pranimin ose jo të studentëve (rang lista përfundimtare), në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve.

Neni 8

Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të fillojë pas shpalljes së listës përfundimtare dhe do të zgjasë 14 ditë pas publikimit të shpalljes së listës përfundimtare.



VI. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

Neni 9

9.1. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim në Kolegjin "Pjetër Budi" është:

9.1.1. Fletëparaqitja për aplikim;

9.1.2. Dëftesat origjinale të të gjitha klasave të shkollës së mesme dhe diploma origjinale e shkollës së mesme;

9.1.3. Certifikata e lindjes.

VII. Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim

Neni 10

10.1. Pas aplikimit për regjistrim, nëse studenti kalon testin pranues, dokumentacioni i nevojshëm shtesë për regjistrim në Kolegj është:

10.1.1 Letërnjoftimi (kopje);

10.1.2 Tri fotografi (formati 6:9 cm);

10.1.3 Indeksi.

Neni 11

Pas publikimit të listës përfundimtare të studentëve të pranuar, bëhet nënshkrimi i Kontratës për shkollimin në Kolegjin "Pjetër Budi" dhe aneks kontratës për përcaktimin e mënyrës së pagesës së shkollimit.

Neni 12

12.1. Kolegji "Pjetër Budi", regjistron studentë të rregullt dhe me korrespondencë.

12.2. Gjatë aplikimit për regjistrim, si studentë me korrespondencë, studenti është i obliguar të paraqes kontratën e punës, me qëllim të dokumentimit të statusit si i punësuar.

Neni 13

Paraqitja e dokumentacionit për aplikim dhe regjistrim në Kolegj bëhet në adresën: Kolegji "Pjetër Budi", Rruga Gazmend Zajmi, nr:33, 10.000 Prishtinë - Kosovë.

Neni 14

Kjo rregullore, shfuqizon rregulloren e vjeter per proceduren e percaktimit te procedurave per regjistrimin e studenteve.

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Kolegjit "Pjetër Budi" - Prishtinë.

Rektori i Kolegjit

Prof. Ass. Dr. Artan Haziri